



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 1, Datë 15/3/2022

“Për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar - përfaqësues i studentëve dhe vendit vakant për sekretar, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Drejtësisë të UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për këto vende”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 7; shkresës datë 07.12.2021 si dhe Vendimit nr. 2, datë 03.03.2022 të Komisionit të Zgjedhjeve të Fakultetit të Drejtësisë të UT-së, në mbledhjen e datës 15.03.2022, KIZ i UT-së:

VENDOSI:

1. Shpalljen e fillimit të procesit të vetëkandidimit për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar - përfaqësues i studentëve, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Drejtësisë të UT-së.
2. Shpalljen e fillimit të procesit të vetëkandidimit për plotësimin e vendit vakant për sekretar, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Drejtësisë të UT-së.

3. Aplikimi i kandidatëve për këto vende, fillon në datën 16.03.2022 dhe përfundon në datën 23.03.2021, nga ora 08:00 – 15:00. Aplikimi i kandidatëve kryhet pranë Sekretarisë Teknike të KIZ, pranë Rektoratit të UT-së, ose elektronikisht, në adresën kizut2021@unitir.edu.al, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.

4. Ky Vendim dërgohet për zbatim në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së.

5. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të UT-së dhe të Fakultetit të Drejtësisë, si dhe në mjediset e Fakultetit të Drejtësisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Edvin Lame | (Kryetar) |
| 2. Xhensila Kadi | (Anëtare) |
| 3. Alnida Koroshi | - // - |
| 4. Shaniko Allajbeu | - // - |
| 5. Arjan Tushaj | - // - |
| 6. Eljon Doçe | - // - |
| 7. Dhurata Saraçi | - // - |

